



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr.067/2021

Nr. Protokoli: 100/2021

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik Seticommerc SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K., Shiroke-Suharek, 23000, SHIROKË
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	02.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** datë, **28.06.2021** Grup i Operatorëve Ekonomik Seticommerc SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K., Shiroke-Suharekë, 23000, SHIROKË, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndertimi i rrugeve lokale; Bubulina , Xhavit Kelmendi , Milaim Bugari Shaban Polluzha dhe rrug te tjera lokale Suharekë**” me Nr. të Prokurimi: 624-21-609-5-2-1 & 624-021-041-521 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Pjesërsht** kërkesa për ri-shqyrtim e datës **28.06.2021** të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Grup i Operatorëve Ekonomik Seticommerc SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K., Shiroke-Suharek, 23000, SHIROKË** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **Ndertimi i rrugeve lokale; Bubulina , Xhavit Kelmendi , Milaim Bugari Shaban Polluzha dhe rrug te tjera lokale Suharekë**” me Nr. të Prokurimi: 624-21-609-5-2-1 & 624-021-041-521.
- II. **Anulohet njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 23.06.2021 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 28.06.2021 ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik **Grup i Operatorëve Ekonomik Seticommerc SH.P.K.; CONSTRUMAX SH.P.K., Shiroke-Suharek, 23000, SHIROKË** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndertimi i rrugeve lokale; Bubulina , Xhavit Kelmendi , Milaim Bugari Shaban Polluzha dhe rrug te tjera lokale Suharekë** me Nr. të Prokurimi: 624-21-609-5-2-1 & 624-021-041-521.

Pas verifikimit të të dhënave në lidhje me pretendimet ankimore të kërkesës për ri-shqyrtim të paraqitura nga ana juaj, ne kemi konstatuar se kërkesa juaj është pjesërisht e bazuar dhe se ky aktivitet duhet të ri-vleresohet dhe të verifikohet serish cdo pozicion nga komisioni për ri-vleresim paramamasa dhe paralogaria dhe komplet dokumentacionin e sipas dokumenteve të ofertuar nga OE.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

